



04-1006
Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Duke u bazuar në nenin 23 të Ligjit të Planifikimit Hapësinor nr. 2003/14, dt. 03.07.2003, nenit 19 al. 2, neni 21 të Ligjit të Ndërtimit Nr. 04/L-110, dt. 31.05.2012, nenit 13, 14 të Ligjit të Procedurës Administrative, nr. 02/L-28, dt. 22.07.2005, nenit 17 al.1 pika "b" "d" dhe "e" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dt. 20.02.2008, neni 57 pika "c" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr. 110-391, dt. 25.02.2010, duke vendosur sipas kërkesës për leje ndërtimore nr.05-351-28350 dt.02.08.2012, të pronarëve, **Habib Leci, Hasim Dërmaku, Jahir Ahmeti, Sebush Dërmaku, Hasan Dërmaku, Habim Dërmaku, Naim Murati, Qamil Hajrizi, Agron Stublla, Fadil Grajçevci, Feti Gashi dhe Hysen Hajdini** nga Prishtina, me investitor "**Pozhegu Brothers**" nga Fushëkosova, për lejimin e ndërtimit të objektit shumbanesore me afarizëm (objekti C11/B/15, sipas zgjidhjes urbane dhe projektit ideor të miratuar), në kuadër të bllokut urbanistik "C11" të Planit Rregullues "Mati 1", konkretisht në kuadër të pjesës së parcelave të bashkuara (nr.824/2, 824/14, 824/21, 826/1, 826/3, 826/4, 826/5, 826/6, 826/7, 826/8, 826/9, 827/1, 827/2, 827/3, 827/4, 830/17, 830/18 dhe 830/19 ZK Matiçan) të bllokut "C11", Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës, lëshon këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET **Habib Leci, Hasim Dërmaku, Jahir Ahmeti, Sebush Dërmaku, Hasan Dërmaku, Habim Dërmaku, Naim Murati, Qamil Hajrizi, Agron Stublla, Fadil Grajçevci, Feti Gashi dhe Hysen Hajdini** nga Prishtina, me investitor "**Pozhegu Brothers**" nga Fushëkosova, ndërtimi i objektit shumbanesor me afarizëm (objekti C11/B/15, sipas zgjidhjes urbane dhe projektit ideor të miratuar), në kuadër të bllokut urbanistik "C11" të Planit Rregullues "Mati 1", konkretisht në kuadër të pjesës së parcelave të bashkuara (nr.824/2, 824/14, 824/21, 826/1, 826/3, 826/4, 826/6, 826/7, 826/8, 826/9, 827/1, 827/2, 827/3, 827/4, 830/17, 830/18 dhe 830/19 ZK Matiçan) të bllokut "C11" me etazhitet **3B+P+9**, me sipërfaqe në bazë **S=382.65m²** dhe sipërfaqe totale të objektit **S=4521.64m²** (3184.89m² mbi tokë dhe 1336.75m² nën tokë).

II. Hartimin e projektit kryesor për objektin investive nga pika I e këtij aktvendimi e ka bërë kompania projektuese **N.P. "Maden Studio Kreative"** nga Prishtina me numër të licencës nr.1730 dt.28.06.2010 dhe valid deri më 10.05.2013, ndërsa revidimin e ka bërë **N.P. "Alba Conak"** nga Gjakova me numër të licencës nr.1438 dt.18.12.2010 me validitet deri më 01.03.2012.

III. Sipas projektit kryesor të prezantuar në objekt janë projektuar **3 banesa** në etazhin e tretë dhe nga **4 banesa** në etazhe tjera, ku totali i banesave në objekt **35 banesa** në total dhe lokale në përdhës me sipërfaqe **S=163.87m²**.

IV. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është situacioni i lokacionit me objekt sipas vijës rregulluese dhe asaj ndërtimore të përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo Drejtori, e i cili do të shërbejë si bazë për rivelimin gjeodezik të objektit nga pika I. e këtij Aktvendimi.

V. Investuesi është i obliguar:

- Që të ruajë një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit, është dhënë kjo leje ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimit të kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ta lajmëroi këtë Drejtori dhe Drejtorinë e Inspeksionit për ditën e fillimit të punës, së paku 8 (tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të fiksimit dhe piketimit të shtrirjes së objektit brenda lokacionit.



- Me rastin e lajmërimit të kësaj Drejtorie duhet të prezantohen:
 - Kontrata për firmën e punëve zbatuese e licencuar.
 - Kontrata për inxhinierin mbikëqyrës dhe inxhinierët ekspert për të gjitha fazat e ndërtimit, të licencuar.

- Që pas kryerjes së themeleve ta lajmërojë këtë organ, në mënyrë që të bëhet kontrollimi i ndërtimit të themeleve dhe konstatimi se ato janë ndërtuar në harmoni me kushtet urbanistike- teknike projektin dhe për këtë të merret vërtetimi me shkrim.
- Të lejohen inspektorët të verifikojnë gjatë ndërtimit ose në çdo kohë pas kryerjes së ndërtimit të objektit për të cilën është dhënë leje ndërtimi se ndërtimi është kryer në bazë të lejes së ndërtimit dhe kushteve urbanistike-teknike të caktuara.

VI. Investitori është i obliguar që 7ditë pas përfundimit të objektit të paraqet kërkesën për kontrollimin teknik profesional te ky organ me qëllim të fillimit të procedurës për pajisje me **Certifikatë të përdorimit** komform me nenin 27 dhe 28 të Ligjit të Ndërtim Nr. 04/L-110, dt. 31.05.2012.

Në rast se gjatë ndërtimit janë bërë ndryshime të projektit zbatues (gjatë realizimit të punimeve) investitori është i obliguar të prezantojë projektin e objektit në tërësi sipas zbatimit.

VII. Leja e ndërtimit vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit me të drejtë vazhdimi edhe për një vit tjetër.

A r s y e t i m

Habib Leci, Hasim Dërmaku, Jahir Ahmeti, Sebush Dërmaku, Hasan Dërmaku, Habim Dërmaku, Naim Murati, Qamil Hajrizi, Agron Stublla, Fadil Grajçevci, Feti Gashi dhe Hysen Hajdini nga Prishtina, me investitor **"Pozhegu Brothers"** nga Fushëkosova, me bazë të kërkesës nr.05-351-28350 dt.02.08.2012 i janë drejtuar kësaj Drejtorie për lejimin e ndërtimit të objektit shumbanesor me afarizëm në lokacionin e përshkruar në pikën I. të dispozitivit të këtij Aktvendimi.

Bashkangjitur me kërkesë investitori ka paraqitur këtë dokumentacion:

- Lejen urbanistike nr. 05-350-19832/1 dt. 05.06.2012, të lëshuar nga kjo Drejtori,
- Konkluzioni i paraprojektit nr.05-350-19832/1 dt.05.06.2012, të lëshuar nga kjo Drejtori,
- Konkluzionin e projektit ideorë nr.05-350-22302 dt.03.07.2012,
- Projektet kryesore në 3 kopje,
- Elaboratin i mbrojtjes nga zjarri hartuar nga N.T.SH."DIARKO"shpk. nga Prizreni me numër të licencës nr.356/1 dt.30.09.2009 me vlefshmëri 30.09.2012.
- Proven mbi pagesën e kompenzimit për rregullimin e tokës ndërtimore të llogaritur sipas Aktvendimit nr. 05-351-28350 dt.24.09.2012, vlera 43,036.84 € e paguar në bankën "Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C." në Prishtinë me dt.01.10.2012.
- Pëlqimi nga Ministria e punëve të brendshme nr.49 dt.15.08.2012 për dokumentacionin teknik për siguri nga zjarri,
- Marrvëshjen për ri - rregullimin e kufijëve të ngastrave kadastrale sipas Planit Rregullues "Mati 1", të lidhur në mes të Komunës së Prishtinës dhe palëve Sebush Dërmaku, Habim Leci, Feti Gashi, Hasim Dërmaku, Fadil Grajçevci, Jahir Ahmeti, Habim Dërmaku, Agron Stublla, Naim Murati dhe Qamil Hajrizi me investitor "Pozhegu Brothers" sipas kërkesës nr.010-46-23461 dt.27.07.2012.
- Pëlqimet për kyçje nga KEK-u me nr. 4974 dt. 22.06.2012,
- Pëlqimin për kyçje nga UR "Prishtina" me nr. 1058/1 dt. 11.07.2012,
- Pëlqimin për kyçje nga Termokosi me nr. 770/1 dt. 27.06.2012,
- Vërtetimin se nuk ka obligime tatimore me nr. 010/435-34342 dt.21.09.2012, nr.21924793/31930243 dt.12.10.2012, nr.21920902/31926155 dt.12.10.2012, nr.21920895/31926147 dt.12.10.2012, nr.21924234/31929642 dt.10.12.2012, nr.21924241/31929649 dt.12.10.2012, nr.21920914/31926168 dt.12.10.2012, nr.21920912/31926167 dt.20.09.2012, nr.21930388/31936117 dt.02.10.2012,

nr.9353964349/8353963481 dt.12.10.2012, nr.2192812/3194936 dt.12.10.2012 ,
nr.2197273/31910208 dt.12.10.2012.

- Kontratat mbi ndërtimin e përbashkët,nr. i LRP-së : 474/12 me numër të referencës dhe origjinalit :nr.76/12 dt.17.09.2012,të nënshkruar në mes të bashkpronarve Habib Leci, Hasim Dërmaku, Jahir Ahmeti, Sebush Dërmaku, Hasan Dërmaku, Habim Dërmaku,Naim Murati,Qamil Hajrizi,Agron Stublla, Fadil Grajçevci, Feti Gashi dhe Hysen Hajdini nga Prishtina , me investitor "Pozhegu Brothers" nga Fushëkosova nënshkruar te Noteri Safedin Blakaj nga Prishtina.
- Kopjen e planit nr.824/14 dhe nr.826/3 ZK Matiçan,ne emër të Habib Lecit,
- Kopjen e planit nr.826/1 ZK Matiçan,ne emër të Hasim Dërmakut
- Kopjen e planit nr.824/21,nr.826/4,nr.826/6,nr.824/2 dhe nr.826/5 ZK Matiçan,ne emër të Jahir Ahmetit,
- Kopjen e planit nr.827/1 dhe nr.827/2 ZK Matiçan,ne emër të Sebush Dërmakut,
- Kopjen e planit nr.827/3 ZK Matiçan,ne emër të Hasan Dërmakut,
- Kopjen e planit nr.827/4 ZK Matiçan,ne emër të Habim Dërmakut,
- Kopjen e planit nr.830/17 ZK Matiçan,ne emër të Naim Muratit,
- Kopjen e planit nr.830/18 ZK Matiçan,ne emër të Qamil Hajrizit,
- Kopjen e planit nr.830/19 ZK Matiçan,ne emër të Agron Stubllës,
- Kopjen e planit nr.826/7 ZK Matiçan,ne emër të Fadil Grajçevcit,
- Kopjen e planit nr.826/8 ZK Matiçan,ne emër të Feti Gashit,
- Kopjen e planit nr.826/9 ZK Matiçan,ne emër të Hysen Hajdinit,

Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit duke shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin e bashkangjitur, ka vërtetuar se investori ka prezantuar tërë dokumentacionin e nevojshëm e të paraparë me rregullativën ligjore nga lëmia e ndërtimit dhe bazuar në kushtet e Planit Rregullues "Mati 1" konstatoj se, janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për lëshimin e kësaj Leje Ndërtimi dhe i njëjti është në harmoni me kushtet urbanistiko-teknike dhe standardet tjera për llojin përkatës të ndërtimit, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi.

I dorëzohet:


- Investitorit,
- kësaj Drejtorie,
- Drejtorisë për Pronë dhe Financa,
- Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim Lokal,
- Drejtorisë së Inspektionit,
- Drejtorisë së Kadastrit,
- dhe në arkiv.

DREJTORIA E URBANIZMIT NDËRTIMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT E KOMUNËS
SË PRISHTINËS 05 NR.351 - 28350 DT. 22.10.2012

Punoi:
Ark.Ergyn Hajredini,inxh.dip.

Kontrolloi:
Ark.Sazan Raskova,inxh.dip.

DREJTORI:
Behxhet Musliu,jur.dip.





mad d

 CREATIVE STUDIO

Projektori Projektues	Investitori Investitor
Republika Republika	Pozhegu BROTHERS
Objekti Objekt	C11/B15
SITUACIONI Situacione	KSHB Mati HV
Data dhe vend Data dhe vend	Skala Skala
08.04.2012 08.04.2012	1:300 1:300
	Az. or Az. or
	A A
	D.3 D.3



Nr. i LRP-së: 2556/13a; (akt en brevet)

Sefadin Blakaj, M.A., Noter,

VËRTETIM I DOKUMENTIT ME ORIGJINALIN -----

Me tridhjetë maj dy mijë e trembëdhjetë, para meje Sefadin Blakaj, Noter në Prishtinë, në rrugën UÇK Hy. 54, nr.2, me kërkesë dhe në prani të **Z. Qemajl Pozhegu**, i lindur në Gjakovë, më 13 qershor 1984, i identifikuar sipas leternjoftimit me nr.personal 1002666851, të leternjoftimit të lëshuar nga MPB. e Republikës së Kosovës, me datë 20.11.2009, e vlefshme deri 20.11.2014; me aftësi veprimi; -----

Dokumenti që kërkon **Z. Pozhegu**, që ti lëshohet në një kopje të vërtetuar është i titulluar si: "Aktvendim", i lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit ,Ndërtimit, dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës **05 Nr.351-28350** të datës **22.10.2012**, si dhe i njëjti i nënshkruar dhe i vulosur me vulën e rumbullakët nga Drejtoria e Urbanizmit në Prishtinë, dokumenti ka të bashkangjitur edhe një skicë të formatit A3, ky dokument është i përbërë prej dy fletë dhe tri faqe A4 dhe një fletë dhe një faqe A3.-----

Ky dokument, në çdo aspekt është konform dokumentit i cili nga pala është prezantuar si origjinal, është fotokopjuar në këtë zyrë të Noterit dhe pas krahasimit është vërtetuar. Njëherit, e njëjta është vulosur me vulën e noterit. -----

Dokumentin e përcaktuar nga **Z. Pozhegu**, si origjinali, e ka sjellë vetë ai dhe të njëjtin e tërheqë me kopjen e vërtetuar.. -----

Ky vërtetim i bashkëngjitet dokumentit të vërtetuar si faqja e katërt dhe fleta e tretë A4. Veprimi i noterizimit u krye në Prishtinë me tridhjetë maj maj dy mijë e trembëdhjetë. -----

Shpenzimet për punën e noterit janë paguar në shumën prej € 5.50 (me Tvsh e përcaktuar në çmim) të përcaktuara me UA 02/12 mbi tarifaf, Neni 27 dhe Neni 41.4

NOTERI : Sefadin Blakaj, M.A.:

